



Numri: KSC-CC-2019-07

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar i panelit
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 nëntor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Në vëmendje të: **Parashtruesit**
Driton Lajçi

Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes

1. Më 14 nëntor 2019, z. Driton Lajçi i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese një kërkesë referuese që mban datën 13 nëntor 2019 ("Kërkesa Referuese"), në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta").
2. Më 15 nëntor 2019, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese me përbërje si më lart, për të vendosur në lidhje me kërkesën referuese.
3. Në kërkesën referuese, Parashtruesi ankohet në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje zbatuar prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

4. Duke qenë se kërkesa referuese ka të bëjë me sjelljen dhe veprimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Paneli i lejon Prokurorit të Specializuar që, në rast se dëshiron, të parashtrojë kundërpërgjigjen e vet ndaj kërkesës referuese.
5. Kundërpërgjigjja e mundshme duhet të paraqitet **më ose para datës 2 dhjetor 2019.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland
Kryetar i panelit

Hartuar në anglishte, e hënë, 18 nëntor 2019
Në Hagë, Holandë